

THE KOSOVO BANKER

A është i sigurt bankimi dixhital?

Pse është e rëndësishme valuta dixhitale?

A është valuta dixhitale e njëjtë me kriptovalutën?

Nga bankingu dixhital në valutat dixhitale dhe përtej





PRINCIPLES FOR
RESPONSIBLE
BANKING

NE JEMI PIONIERË TË QËNDRUESHMËRISË:
NGA PËRGJEGJËSIA PËR TË ARDHMEN.

RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL ËSHTË BANKA E PARË NË AUSTRI QË NËNSHKRUAN PARIMET E KB PËR BANKIM TË PËRGJEGJSHËM. Me këtë, ne përkusohemi për Bankim të përgjegjshëm për një të ardhme të qëndrueshme. Si bankierë të përgjegjshëm, ne mbështesim klientët tanë në Austri dhe EQL me produkte të qëndrueshme financiare dhe njohuri teknike gjithpërfshirëse.
www.rbinternational.com/sustainability



**Raiffeisen Bank
International**

Member of RBI Group



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



THE KOSOVO BANKER

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



ALBERT LUMEZI
NLB Bank / Kryetar i Bordit të SHBK



SUAT BAKKAL
Banka Kombëtare Tregtare /
Zv. Kryetar i Bordit të SHBK



PETRIT BALIJA
Shoqata e Bankave të Kosovës



ARTION CELINA
Banka për Biznes



ERIOLA BIBOLLI
ProCredit Bank Kosova



MERITON SUNDURI
Ziraat Bank



OGUZHAN CEYLAN
IS Bank



ORCUN OZDEMIR
TEB Bank



ROBERT WRIGHT
Raiffeisen Bank



SELMAN LAMA
Credins Bank



SHPEND LUZHA
Banka Ekonomike

KRYEREDAKTOR:
Petrit Balija

REDAKTORE:
Anesa Besimi



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Mediat me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës 177, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

PËRMBAJTJA

EDITORIAL

- 06 **PETRIT BALIJA** - Kryeshef Ekzekutiv -
Shoqata e Bankave të Kosovës

KËNDI I INTERVISTËS

- 07 **Avancimet dixhitale në shërbimet bankare**
SUAT BAKKAL - Kryeshef Ekzekutiv,
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë



- 11 **Transformimi dixhital i shërbimeve bankare**
ADONIS BLLACAKU
Udhëheqës i Departamentit të Retail dhe
Marketingut, Banka për Biznes



KËNDI I INSTITUCIONEVE

- 13 **ARIJETA NEZIRAJ ELSHANI**
Drejtoresh Menaxhuese, Fondi për Sigurimin
e Depozitave në Kosovë

SEKTORI FINANCIAR

- 17 **Evolucioni i parasë – nga perspektiva e shtetit**
- PARTIN PRUTHI - Udhëheqës Ligjor, Zyra
Qendrore, Teb Bank Sh. A.



- 19 **Menaxhimi i zhvillimeve rreth valutave dixhitale nga perspektiva e GRC-së -**

MUSA BAJRAKTARI - Zyrtar i Lartë për Paj-
tueshmëri, NLB Banka Sh. A. Prishtinë

VISAR MALOKU - Udhëheqës i Njësisë për
Pajtueshmëri dhe Integritet, NLB Banka Sh. A.
Prishtinë



KËNDI I EKSPERTËVE

- 21 **Përdorimi i kartave të pagesave në kohën e
financave dixhitale - ENEIDA THOMAJ**, Drejtore
Menaxhuese, Paylink Sh. A

- 25 **Dixhitalizimi i shërbimeve financiare – Vështrim
mbi kornizën ligjore dhe rregullative -**
MENTOR HAJDARAJ - Partner, RPHS Law
FISNIK SALIHU - Partner Menaxhues, RPHS Law

- 28 **SEKTORI BANKAR NË
SHIFRA**

- 29 **AKTIVITETET E SHBK**



- 37 **BANKAT FUQIZOJNË
SHOQËRINË**





DIGITALIZE THE FUTURE OF PAYMENT



PayLink is an Albanian technology and payments processing company that provides services for financial markets.

Certified by:



www.paylink.al
+355 4 238 7061 info@paylink.al

Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës,
Km 8, Gjokaj - Vorë (pranë CityPark), Tiranë, Albania

EDITORIAL



PETRIT BALIJA

KRYESHEF EKZEKUTIV - SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Zhvillimet teknologjike janë duke ecur me një ritëm të shpejtë. Veçanërisht me goditjen e pandemisë COVID-19, ku është vërejtur një përshpejtim i zhvillimeve teknologjike në të gjithë sektorët ekonomik.

Pandemia ka rritur tendencat e mëparshme duke avancuar në një shkallë që nuk mund ta kishim parashikuar kurrë. Në 2021, ekonomia jonë nuk do të mund të kishte një zhvillim rikuperues pa ndikimin e faktorëve të nevojshëm teknologjik.

Kompanitë në të gjithë sektorët ekonomik janë duke i dixhitalizuar shërbimet dhe produktet me një ritëm shumë herë më të shpejtë sesa ka qenë e planifikuar dhe e menduar.

Dixhitalizimi i punëve, i shërbimeve dhe produkteve, ndryshe i njohur si Industrializimi 4.0, i dedikohet përdorimit të teknologjisë dixhitale në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në ekonomi. Kjo teknologji e re, do të mundësojë jo vetëm rritjen e shpejtësisë dhe saktësisë së shërbimeve por pritet të ndryshojë rrënjësisht edhe tregjet në ekonomi, sidomos tregun e kuadrove njerëzore.

Lehtësia dhe inovacionet e financave të hapura do të kapërcejnë hendekun midis hapësirës dixhitale dhe botës financiare tradicionale për sa i përket dixhitalizimit të produkteve. Ndërsa pagesat dixhitale po rriten, ato shpejt do të bëhen më të rëndësishme për industrinë që ofrojnë mallra dhe shërbime. Nevoja dhe kërkesa e popullatës për avancim të produkteve dhe shërbimeve do krijojë një integrim unik që nxit rritjen dhe inovacionin.

Së fundmi janë hapur edhe diskutime serioze në Bankën Qendrore Evropiane në lidhje me lansimin e valutës dixhitale e cila pritet të ketë një ndikim të madh në sektorin financiar dhe në veçanti në sistemin e pagesave. Mundësitë dhe rreziqet janë ende të pa qarta dhe debati në këtë temë është mjaft kontravers.

Në këtë edicion të “The Kosovo Banker” ju ftojmë të ndiqni pikëpamjet më të reja nga bankingu dixhital në valutat dixhitale dhe përtej. Jemi falënderues për autorët dhe sponsorët që na mbështetën në realizimin e këtij edicioni.





SUAT BAKKAL
Kryeshef Ekzekutiv,
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë

Avancimet dixhitale në shërbimet bankare

Ne vazhdimisht jemi duke i zhvilluar shërbimet tona dixhitale për t'u ofruar klientëve tanë një përvojë të personalizuar në të gjitha aspektet e raportit të tyre me ne.

Dixhitalizimi është bërë thelbësor ndërsa bankat komerciale përpiqen të përvetësojnë normën e re dhe të zbatojnë metoda më efektive të shërbimit për të qëndruar konkurrues dhe për t'i dhënë vlera maksimale klientëve.

Para vitit 2020, ritmi i dixhitalizimit të shërbimeve bankare nuk ishte i njëjtë në çdo vend. Pandemia ka përshpejtuar dukshëm dixhitalizimin e produkteve dhe shërbimeve bankare që tashmë ishin në proces e sipër, thotë Z. Suat Bakkal, Kryeshef Ekzekutiv dhe Anëtar i Bordit të BKT Kosova. Ka gjithashtu një vëmendje të konsiderueshme në valutat dixhitale, ku trajektorja është më pak e qartë ndërsa pjesëmarrësit e tregut e vlerësojnë këtë mundësi si një sektor me vlerë. Derisa kriptovalutat të rregullohen në mënyrë të duhur, është e vështirë që industria të angazhohet në këtë drejtim, pasi trajtimi rregullator i tyre aktualisht është i paqartë dhe kompanitë ballafaqohen me riskun e shkeljes së rregullave të rregullatorit. Kjo në vetvete mund të pengojë inovacionin. Rregullimi i duhur mund të jetë një hap tjetër i arsyeshëm në një fazë tjetër, thotë z. Suat Bakkal.

Banka Kombëtare Tregtare në Kosovë në vazhdimësi është duke përditësuar shërbimet e saj dixhitale bankare dhe është përqendruar t'i siguroj klientëve të saj qetësi, komoditet, bankë të sigurt dhe në kohë reale. Zotimi i saj drejt dixhitalizimit është njohur ndërkombëtarisht duke u shpërblyer me çmimin prestigjioz **“Best Digital Bank Kosovo 2021” (Banka më e mirë dixhitale në Kosovë për vitin 2021)** nga Global Banking & Finance, në mesin e shumë çmimeve të tjera që banka mori këtë vit.

“Gjatë dy viteve të fundit, BKT Kosova është përqendruar në mënyrë intensive në shërbimet e dixhitalizimit duke ecur përpara me prezantimin e kanaleve të reja të shërbimeve



GJATË DY VITEVE TË FUNDIT, BKT KOSOVA ËSHTË PËRQENDRUAR NË MËNYRË INTENSIVE NË SHËRBIMET E DIXHITALIZIMIT DUKE ECUR PËRPARA ME PREZANTIMIN E KANALEVE TË REJA TË SHËRBIMEVE DIXHITALE QË E KA BËRË TË MUNDUR BANKIMIN PËR TË GJITHË KUDO QË JANË, DHE SI PASOJË, KLIENTËT TANI MUND TË KRYEJNË SHËRBIME BANKARE NGA REHATIA E SHTËPISË OSE ZYRËS SË TYRE

dixhitale që e ka bërë të mundur bankimin për të gjithë kudo që janë, dhe si pasojë, klientët tani mund të kryejnë shërbime bankare nga rehatia e shtëpisë ose zyrës së tyre”, thotë Suat Bakkal, Kryeshef Ekzekutiv dhe Anëtar i Bordit të BKT Kosova.

Z. Bakkal thotë: “Ne kemi lançuar funksionin Kredia Dixhitale, që është produkti ynë më i ri dhe gjer më tani i pari në tregun e Kosovës. Është menduar për të gjithë klientët e BKT që mund të aplikojnë 24/7 përmes aplikacionit bankar celular për një kredi personale deri në 5,000 euro, në një proces që përfundon pas 4 hapash dhe brenda 5 minutash, duke marrë përgjigjen e miratimit ose refuzimit në çast. Por, BKT nuk do të ndalet vetëm me këtë produkt novator, por së shpejti pritet të sjellë produkte të reja dixhitale, siç janë Kredit Karta Dixhitale dhe Mbitërheqja Dixhitale.”

“Duke filluar nga java e dytë e majit 2020, banka jonë lançoi shërbimin më të ri në kanalet tona dixhitale dhe të shërbimit ndaj klientit, sistemin IVR të kombinuar me Bankimin Telefonik. Sistemi IVR është shkurtësë për “Përgjigja Interaktive Zanore” (nga gjuha angleze Interactive Voice Response) që është teknologji e krijuar për të gjithë klientët

individë të BKT që duan të marrin informacion në lidhje me llogaritë e tyre dhe kartat e kreditit nga BKT, aty për aty dhe 24/7 përmes një telefonate, pa pasur nevojë të flasin me një agjent. Nga ana tjetër, Bankimi Telefonik si shërbimi më i ri i këtij lloji në tregun bankar të Kosovës u dedikohet të gjithë klientëve individë të BKT të cilët nuk mund ose nuk preferojnë të vizitojnë një degë ose përkohësisht nuk kanë qasje në kanalet bankare në internet, por duhet të kryejnë transaksione bankare. Në këtë kontekst, Bankimi Telefonik u mundëson klientëve të transferojnë para, të paguajnë fatura, të paguajnë llogaritë e kartave dhe shumë shërbime të tjera të cilat ofrohen në mënyrë të ngjashme në bankimin celular”, shpjegon Z. Bakkal.

Një rezultat tjetër i përpjekjeve të bankës për dixhitalizim ishte lançimi i platformës së saj “Smart Invest” në dhjetor 2019. Banka e konsideron veten të privilegjuar që është pioniere e lançimit të platformës së parë dhe të vetme lokale të investimeve, e cila u hapi dyert qytetarëve të Kosovës për të hyrë në tregjet financiare ndërkombëtare. “Smart Invest” u jep klientëve qasje të drejtpërdrejtë në produkte të ndryshme si FX, mallra dhe stoqe, jo vetëm në tregjet e nivelit më të lartë si SH.B.A., Gjermania, Japonia ose Mbretëria e Bashkuar, por



Para vitit 2020, ritmi i dixhitalizimit të shërbimeve bankare nuk ishte i njëjtë në çdo vend. Pandemia ka përshpejtuar dukshëm dixhitalizimin e produkteve dhe shërbimeve bankare që tashmë ishin në proces e sipër, thotë Z. Suat Bakkal, Kryeshef Ekzekutiv dhe Anëtar i Bordit të BKT Kosova.



edhe në Afrikën e Jugut, Peru dhe shumë tregje të tjera, ku ata mund të tregtojnë me investitorë ndërkombëtarë.

Vetë platforma u ofron klientëve qasje të drejtpërdrejtë dhe të lehtë për përdoruesit, që do të thotë se ata mund të kryejnë çdo investim në mënyrë të pavarur, pa pasur nevojë të paraqesin kërkesa në bankë. Klientët e interesuar mund të kryejnë investime me një klikim me çmimet më të mira të tregut duke përdorur platformën “Smart Invest” të bankës, qoftë përmes e-banking ose bankimit me celular. “Smart Invest” u lejon klientëve të monitorojnë tregjet në telefonin e tyre, ku ata gjithashtu mund të lexojnë lajmet e ndërlidhura në çast, të marrin paralajmërime dhe njoftime, të bëjnë porosi dhe analiza teknike. Përveç kësaj, klientët janë në gjendje të shohin historinë e investimeve të tyre, analizën e performancës, lëvizjet në llogari dhe shumë më tepër informacion me transparencë të plotë.

BKT Kosova ka ndërmarrë projektin “Kondor” për të rritur automatizimin në proceset e Thesarit. Kjo platformë ku regjistrohen të gjitha produktet e Thesarit, përdoret edhe nga bankat ndërkombëtare. Platforma lejon përpunimin e drejtpërdrejtë të “STP” për transaksionet e bëra në platformat

ndërkombëtare. Në platformë përkufizohen kufijtë e renditur në vijim në mënyrë që departamentet përkatëse të mund të njoftohen dhe të monitorojnë automatikisht: kufijtë në nivel vendi, kufijtë e kredisë dhe shlyerjes së palës tjetër, kufijtë e pozicionit, kufijtë e ndalimit të humbjes dhe kufijtë e përdoruesit. Meqenëse produkti është i lidhur me platforma ndërkombëtare si Bloomberg dhe Reuters, ai llogarit vlerat “MTM” të tregut dhe njësi të tjera matëse të riskut në baza ditore. Kjo platformë e thesarit ndihmon për të rritur efikasitetin në mënyrë të konsiderueshme falë automatizimit të shumicës së proceseve, duke përfshirë funksionet e kontabilitetit, funksionet e back-office, funksionet e kontrollit dhe riskut.

Që nga fillimi i vitit 2019 dhe veçanërisht gjatë vitit 2020, BKT Kosova ka ndërmarrë masa dhe investime në implementimin e shumë projekteve që synojnë transformimin dhe dixhitalizimin e shërbimeve. Krahas punës në transformimin e produkteve dhe shërbimeve ekzistuese, BKT ka zhvilluar produkte të reja që paraqesin aspekt të rëndësishme të rrugëtimit drejt dixhitalizimit, jo vetëm për vetë bankën, por për të gjithë industrinë bankar në vend.



Llogari Rrjedhëse dhe Depozitë me Afat në ARI



Ne jemi gjithmonë këtu!



**ADONIS BLLACAKU**

Udhëheqës i Departamentit të Retail dhe Marketingut,
Banka për Biznes

Transformimi dixhital i shërbimeve bankare

CILA ËSHTË ARSYEJA QË BANKAT PO INVESTOJNË NË DIXHITALIZIM TË SHËRBIMEVE NË VAZHDIMËSI?

Secili institucion financiar po kërkon mënyrën e duhur për transformim dixhital për të përmbushur kërkesat dhe pritjet në rritje të klientëve për shpejtësi dhe komoditet.

Në anën tjetër bankat gjithmonë kanë nevojë të vazhdueshme për të ulur koston e operacioneve dhe përballjen me konkurrencën duke përfshirë nga kompanitë e Fintech që ofrojnë shërbime financiare. Nga të dhënat e fundit rezultoi se një numër i madh i bankave shpenzon më shumë se 10% të të ardhurave vjetore për investime në teknologji. Një investim i madh por i domosdoshëm dhe i paevitueshëm.

Pandemia zbuloi se si institucionet financiare që e konsideronin veten të avancuara në dixhitalizim, në të vërtetë, janë ende të varura nga procese tradicionale dhe analoge në ofrimin e shërbimeve ndaj klientëve. Për shumë institucione kjo ka shërbyer si një pikë kthimi ku secila ka kuptuar që mënyra e shërbimit po ndryshon. Në të kaluarën, shumë banka menduan që nëse kanë web faqe dhe aplikacion për shërbime bankare e ose m-banking, atëherë mjafton. Por tani të gjithë jemi të bindur që nuk është kështu. Shumica e bankave kanë portale në internet dhe aplikacione mobile, por ende kemi nevojë për nënshkrime dhe dokumente fizike të klientëve përfshirë vizitat në teren para se të mund të ofrojmë qasjen në financa. Duke marrë parasysh që kjo gjë që nuk ka qenë e mundshme gjatë vitit të kaluar, ne si banka tani kemi përshpejtuar ritmin që tani ri dizajnojmë dhe të rimodelojmë procesin e shërbimeve dhe produkteve financiare dhe jo financiare.

Në këtë drejtim ne si banka gjithashtu kemi parë mungesën e njohurive në shkallë më të thellë të sjelljes së klientëve tanë gjithmonë duke e ditur se gjurmët dixhitale sot janë vlera më e rëndësishme në përcaktimin e ofertës të secilës industri. Andaj proceset dixhitale do të na ndihmojnë për vendimet e sakta duke e ngritur fleksibilitetin për klientët e cila shpreh nevojat e ndryshimeve të vazhdueshme.

Çka konsideroni ju Bankë Dixhitale dhe sa ka bërë progres banka juaj në këtë drejtim?

Nënkuptohet që një Bankë Dixhitale është një institucioni financiar që mund të ofrojë shërbime dhe produkte bankare përmes kanaleve alternative. E-bankingu është “shpërndarja e automatizuar e produkteve dhe shërbimeve bankare të reja dhe tradicionale drejtpërdrejt te klientët përmes kanaleve elektronike, duke synuar gjithmonë një komunikim sa më interaktiv.



Një bankë dixhitale duhet të jetë në gjendje të sigurojë të gjitha funksionet bankare që janë kryer tradicionalisht në zyrat e degëve dhe përmes kartave bankare në makinat ATM.

Si rezultat edhe BPB ka ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm që të jetë e gatshme ti përshtatet trendeve dhe kërkesave të klientëve. Implementimi i setit të API-ve të ndryshëm, si dhe operacionalizimi i shërbimit dhe produkteve të BPB-së, e përgatisin bankën që në momentin kur nënshkrimi dixhital mundësohet të përdorët nga rregullatori banka të jetë në gjendje të ofrojë të gjitha produktet përmes degëve dixhitale. Megjithëse në masë të madhe tani i kemi mundësuar klientëve tanë ti kryejnë shumicën e shërbimeve duke evituar prezencën fizike në degë përveç atyre shërbimeve të cilat nevojitet nënshkrimi fizik si kërkesë rregullative ndaj bankave.

SA PO SFIDOHEN BANKAT NGA KONKURRENTËT E RINJ TË CILËT OFROJNË SHËRBIME DIXHITALE TË PAGESAVE?

Bankat ende mbajnë një avantazh ndaj lojtarëve të tjerë Fintech por ky kufij midis bankave dhe Fintech-ëve po vazhdon të zvogëlohet me tendencë që në të ardhmen të zhduket, andaj bankat duhet të vazhdojnë të kërkojnë burime të reja vlere në marrëdhëniet e tyre me klientët por edhe ofruesit e tjerë të shërbimeve financiare.

Kjo zhvendosje ka sjellë sfida të reja në planin afatshkurtër, Bankat janë të mira për të përcaktuar se si duhet të jenë proceset, por hierarkia e bankave kufizon aftësinë për të ekzekutuar zhvillime të reja dhe për të qenë mjaft të hapura për të kryer projekte bashkëpunuese me partnerë të tjerë.

Në anën tjetër Fintech-et kanë fleksibilitetin që u mundëson atyre të punojnë në mënyrë më efikase, të zbatojnë dhe të përtërijnë çdo ndryshim të nevojshëm gjë që i bën këto kompani me të manovrueshme në treg dhe ju jap aftësi për të ndryshuar më shpejt. Pagesat janë një fushë në të cilën bankat humbën disa nga pozicionet e tyre në treg por shumicën tani i kanë rikuperuar. Disa vite më parë, kompani të tilla filluan të merrnin formë dhe kjo do të thoshte që këta ofrues të shërbimeve filluan të merrnin mbështetjen për përpunimin e pagesave përmes kanaleve dhe platformave të ndryshme. Andaj në tregjet internacionale janë zhvilluar modele më të mira bashkëpunimi, posaçërisht në pjesën e përpunimit të pagesave. Merrni Apple Pay, një shembull i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit rreth kuletave elektronike. PayPal është gjithashtu një ndërhyrës dhe bashkëpunëtor, dhe tani është një prej metodave të pagesave më të pranuar në të gjithë botën.

Pa diskutim teknologjitë e reja të sjella nga Fintech-et vazhdojnë të sfidojnë status quo-në e industrisë bankare.

Bankat mund të ndjekin shembullin dhe të përshtaten me teknologjitë e reja të disponueshme, gjithmonë duke e pasur në qendër klientin.

A ËSHTË AMBIENTI LEGJISLATIV DHE I TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË I PËRSHTATSHËM PËR SHËRBIME DIXHITALE?

Mendoj se na duhen një sërë reformash për t'u afruar sa më shumë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në vitet e fundit tregon dobinë e lartë të klientit dhe bankave në mbështetjen që ato i japin rritjes së cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e shërbimeve dhe transaksioneve bankare. Sistemet elektronike të regjistrimit e procedimit do duhej të implementoheshin edhe në nivele shtetërore në mënyrë që i gjithë ekosistemi të jetë në harmoni duke përfshirë edhe sistemin financiar. Legjislacioni për momentin nuk është në favor të bankave edhe pse ne si ofrues të shërbimeve jemi të hapur dhe të interesuar që t'i shtyjme projekte të ngjashme përpara. Është e evidente që legjislacioni që i nevojitet sistemit financiar do ta rriste ndjeshëm aksesin, lehtësinë, transparencën e marrjes së këtyre shërbimeve nga klientët individual dhe bizneset. Përdorimi masiv i teknologjisë së informacionit me legjislacionin përkatës bazohet në modelin e ngritjes së rrjeteve të integruara me të gjitha veçoritë e sigurisë së ruajtjes dhe përpunimit të informacionit sipas përcaktimeve ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale e informacionit konfidencial. Në kuadër të këtyre zhvillimeve neve si banka do të na ndihmonte miratimi i legjislacioneve përkatëse nga organet kompetente.



**E-banking është
"shpërndarja e
automatizuar e produkteve
dhe shërbimeve bankare
të reja dhe tradicionale
drejtpërdrejt te klientët
përmes kanaleve
elektronike, duke synuar
gjithmonë një komunikim
sa më interaktiv.**



ARIJETA NEZIRAJ ELSHANI

DREJTORE MENAXHUESE, FONDI PËR SIGURIMIN
E DEPOZITAVE NË KOSOVË

10 vite në mbrojtje të depozitorëve të Republikës së Kosovës

Përvjetori i 10-të i themelimit, e gjen FSDK-në dhe jo vetëm, të ballafaquar me një situatë të paprecedentë. Si pjesë e rrjetës së sigurisë financiare, COVID-19 ka afektuar edhe Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK) pasi që situatat e tilla vënë në pah rolin dhe rëndësinë e këtyre institucioneve në sigurimin e stabilitetit financiar. Andaj, FSDK si entitet i vetëm publik në Kosovë që ofron sigurimin e depozitave, gjatë vitit pandemik, ndërmoi veprimet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e mbarëvajtjes së punës, dhe rriti komunikimin dhe këmbimin e informacionit me rrjetën financiare për të siguruar këmbimin në kohë të informacionit të duhur mbi nivelin e qëndrueshmërisë bankare.

Si rezultat i situatës së krijuar, në këtë përvjetor, po ju drejtohem nga distanca për të ju informuar lidhur me të arriturat e FSDK-së gjatë kësaj dekade.

Nuk mund të mos fillojmë që nga zanafilla e themelimit të FSDK-së dhe të falënderojmë kontribuesit që krijuan kapitalin fillestar të fondit: Ministrinë e Financave, Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe Bankën Botërore. KfW në kuadër të mbështetjes së saj shtesë, ndër vite i ofroj asistencë FSDK-së në vendosjen e gurë-themeleve të para për ndërtimin e bazës rregullatore, operacionale dhe funksionale.

Duke qenë pjesë e rrjetës së sigurisë financiare, që nga themelimi në vitin



Aktivitetet FSDK-së kanë një synim të përbashkët e që është forcimi i mandatit të saj në linjë me misionin, vizionin dhe vlerat e saj. Andaj, FSDK në mënyrë proaktive angazhohet që të përmirësoj dhe të avancojë sistemin e sigurimit të depozitave me qëllim që të ndihmoj në sigurimin e stabilitetit financiar dhe besueshmërisë në sektorin bankar.

2011, FSDK ka menaxhuar Sistemin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë me mandat kryesor sigurimin e depozitorëve dhe garantimin e kompensimit në rast të revokimit të licencës dhe mbylljes së bankës nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Në arritjen e objektivit kryesor në mbrojtje të depozitorëve të vegjël dhe për të siguruar kompensim efikas të depozitorëve të siguruar, FSDK që në fillimet e para ka nisur ndërtimin e bazës së nevojshme rreth funksionit të kompensimit dhe ka miratuar një numër të rregulloreve të brendshme. Në veçanti, FSDK ka hartuar rregullore

të hollësishme për kompensimin e depozitave të siguruar që mbulon të gjitha fushat e procesit të kompensimit.

FSDK nën mbështetjen financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka ndërtuar kornizën operacionale dhe teknike për kompensimin e depozitorëve në rast të mbylljes së një banke (Sistemit të Kompensimit të Depozitave), ka rregulluar procesin e rrjedhës së punës, ka përcaktuar afatet kohore dhe aktivitetet e hollësishme nga faza përgatitore, e gjer tek përfundimi i procesit të kompensimit. Gjithashtu, ka hartuar rregullin e përzgjedhjes së bankës agjente për pagesë e cila do të paguan shumën e kompensuar në emër të FSDK-së. Në linjë me këto zhvillime, FSDK ka realizuar simulime të ngjarjeve të siguruar në vitin 2017, bazuar në skenarin e përgatitur në pajtim me Udhëzuesin e EBA-së, si dhe testime të gatishmërisë operacionale të grupeve të punës dhe Bankës Agjente për Pagesë. Shtesë, gjatë periudhës 2018-2020, FSDK ka realizuar testime me bankat anëtare, me qëllim të testimit të gatishmërisë së tyre për të dorëzuar të dhëna cilësore brenda një afati të caktuar, për përcaktimin e shpejtë dhe të saktë të depozitave të siguruar.

Për të siguruar qëndrueshmëri financiare sipas parametrave të rekomanduar dhe krijimit të qasjes më

10 VITE FSDK

FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË KOSOVË
DEPOSIT INSURANCE FUND OF KOSOVO
FOND OSIGURANJA DEPOZITA NA KOSOVU

të lehtë në likuiditet në rast të mbylljes së një banke, nën mbështetjen dhe garantimin e Ministrisë së Financave, FSDK ka nënshkruar dy (2) Marrëveshje Financiare ndërkombëtare për linja të kredisë në shumë prej 34 milion EUR me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Falë financimit dhe kontributit në kapital, FSDK ka arritur që të rrisë limitin e mbulueshmërisë gjatë kësaj periudhe (nga 3,000 në 4,000 Euro, dhe aktualisht në 5,000 Euro) dhe

sot siguron më shumë se 990 milion euro depozita, e që paraqet trefshin e shumës së siguruar në vitin 2011 kur FSDK-ja ka filluar operimin. Në anën tjetër, mbi 99% e depozitorëve sigurohen nga Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë deri në limitin e sigurimit.

Në rrafshin ndërkombëtar, që nga viti 2013, respektivisht 2017, FSDK-ja është anëtare e Shoqatës ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) dhe e Forumit Evropian të Siguruesve të

Depozitave (EFDI). Anëtarësimi në këto dy institucione i shërbeu ndër këto vite FSDK-së për avancim të vazhdueshëm të kapaciteteve dhe adaptimin e standardeve evropiane në fushën e sigurimit të depozitave. Tutje, me qëllim të përafrimit të Sistemit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë me standardet ndërkombëtare, FSDK-ja gjatë vitit 2015 ka realizuar vlerësimin e pajtueshmërisë me Parimet Themelore të IADI. Rezultatet dhe rekomandimet

e këtij vlerësimi kanë ndihmuar FSDK-në në përcaktimin e objektivave dhe vendosjen e drejtimit strategjik për periudhën 2018-2022, dhe ndërmarjen e aktiviteteve për përmbushjen e rekomandimeve të dalura nga ky vlerësim. Në anën tjetër, bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve ndër vite si KfW, Banka Botërore (FinSAC) dhe BERZH-i në implementimin e projekteve specifike sipas standardeve më të mira ndërkombëtare shënohet si kontribut i veçantë i ndërtimit të deritanishëm të FSDK-së.

Bashkëpunimi me rretën e sigurisë financiare, Ministrinë e Financave dhe BQK-në, shënohet përmes nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit dhe implementimit të tyre ku FSDK-ja është bërë pjesë e Komitetit të Stabilitetit Financiar, i cili kontribuon në koordinimin e përpjekjeve në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar,

veçanërisht lidhur me menaxhimin dhe gatishmërinë në rast krize. Gjithashtu, bashkëpunimi me BQK-në në drejtim të shkëmbimit të informacioneve dhe ekzaminimit të bankave anëtare shënoj forcimin e mandatit të FSDK-së.

Në një periudhë afatmesme aktivitetet e FSDK-së janë fokusuar në rritjen e bashkëveprimit me bankat anëtare, kryesisht në drejtim të implementimit të udhëzimeve që dalin nga Autoriteti Evropian Bankar (EBA) për premiumet e bazuara në rrezik, automatizimit të procesit të raportimit për premiumet dhe rritjes së kualitetit të të dhënave të depozitorëve të dorëzuara në FSDK në mënyrë që kompensimi i depozitorëve dhe kalkulimi i premiumeve të jetë në përputhshmëri me kërkesat e FSDK-së.

Aktivitetet FSDK-së kanë një synim të përbashkët e që është forcimi tutje i mandatit të saj në linjë me misionin, vizionin dhe vlerat e saj. Andaj, FSDK

në mënyrë proaktive angazhohet që të përmirësoj dhe të avancojë sistemin e sigurimit të depozitave me qëllim që të ndihmoj në sigurimin e stabilitetit financiar dhe besueshmërisë në sektorin bankar. Në këtë drejtim, gjatë këtij viti po rishikojmë ligjin e FSDK-së i cili do të avancoj tutje sistemin e sigurimit të depozitave drejt standardeve më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Në fund, të gjitha këto të arritura dhe mandati i FSDK-së nuk do të kishin mundësi të realizoheshin pa iniciativën e Qeverisë së Kosovës, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, KfW-së, dhe partnerëve ndërkombëtar financiar për iniciativën e themelimit të Sistemit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë. Andaj, u jemi mirënjohës dhe falënderues për mbështetjen e vazhdueshme që keni ofruar dhe vazhdoni të ofroni në forcimin e mandatit të sigurimit të depozitorëve në Republikën e Kosovës.

Shkarko
NLB PAY
FALAS



A e keni provuar
sa i lehtë është
përdorimi i **NLB PAY?**





Aftësitë e buta janë thelbësore për të ardhmen e punës

Nëse jeni duke punësuar punonjës, kontraktues të pavarur ose një fuqi punëtore të përzier, të gjithë e dimë se bota po ndryshon me shpejtësi dhe po ashtu po ndryshon mënyra se si bëhet puna. Si rezultat, mënyra se si ne kontrollojmë dhe punësojmë punonjës dhe profesionistë të pavarur ka ndryshuar gjithashtu. Aftësitë e buta - të tilla si empatia, inteligjenca emocionale, mirësia, vëmendja, përshtatshmëria, integriteti, optimizmi, vetë-motivimi, guximi dhe qëndrueshmëria - janë bërë faktorë thelbësorë të suksesit.

Pse aftësitë e buta janë bërë më të rëndësishme

Ndërsa gjithnjë e më shumë aktivitetet e punës bëhen të automatizuara, aftësitë e buta, të cilat ende nuk mund të përsëriten nga makineritë, janë bërë më të rëndësishme. Në vitin 2017, Deloitte raportoi se “profesionet me aftësi të buta do të përbëjnë dy të tretat e të gjitha vendeve të punës deri në vitin 2030” dhe se punësimi i punonjësve me më shumë aftësi të buta mund të rrisë të ardhurat me më shumë se 90,000 dollarë.

Empatia dhe inteligjenca emocionale

Rëndësia e empatisë dhe aftësive sociale-emocionale nuk mund të mbivlerësohet. Ekipe të emocionalisht inteligjente kanë një përparësi konkurruese dhe kam zbuluar se ndjeshmëria është një nga aftësitë më të rëndësishme për

tu punësuar. Të kujdesesh për atë se si ndjehen shokët e tu dhe klientët e tu dhe të ndjesh ndjenjat e tyre të pathëna është aftësi e vërtetë që besoj se rrit produktivitetin dhe të ardhurat. Ndjeshmëria dhe inteligjenca emocionale kërkojnë vetëdije dhe mundësojnë dëgjim më të mirë, duke çuar në përmirësimin e komunikimit.

Kur kontrolloj punonjësit e mundshëm dhe profesionistët e pavarur, më pëlqen të pyes nëse ka çështje bamirëse ose kauza për të cilat kujdesen. Kjo më jep pasqyrë nëse ata kujdesen mjaftueshëm për të tjerët për të ndërmarrë ndonjë veprim. Më pëlqen ta bëj këtë pyetje gjithashtu: “A mund të mendoni për një kohë kur keni punuar me dikë vështirë për tu shoqëruar me të - si i keni trajtuar bashkëveprimet me atë person?” Kjo më tregon nëse empatia dhe inteligjenca e tyre emocionale iu ka mundësuar atyre që jo vetëm të zbusin një situatë sfiduese por ta shndërrojnë atë në fitore.

Integriteti dhe Përgjegjësia Etike

Miliarderi Warren Buffett është kredituar në mënyrë të shkëlqyeshme që e quan integritetin tiparin më të rëndësishëm për të kërkuar gjatë punësimit. Pajtohem që kjo veti e karakterit është kritike për suksesin afatgjatë. Kam zbuluar që punonjësit dhe kontraktorët e mi më të suksesshëm janë ata që janë

etikë, marrin përgjegjësi për sukseset dhe gabimet e tyre, kanë përulësi, respektojnë kohën e njerëzve të tjerë, u japin të tjerëve kredi dhe marrin pronësinë e plotë të punës së tyre - veçanërisht për humbjet. Kur dikush më thotë se ka bërë një gabim dhe se si synon ta rregullojë atë, unë e di që mund t'i besoj. Në botën e sotme me ritme të shpejta, integriteti është edhe më kritik. Është e lehtë të zgjedhësh rrugën e shkurtër dhe të tregosh fitime afatshkurtra, por është më e vështirë të bësh gjërat siç duhet për tu vendosur për një sukses afatgjatë.

Në ditët e intervistave fizike, më pëlqente të pyesja receptionistin se si kandidatët i trajtonin ata (dhe nëse përfshihej një racion, si i ka trajtuar kandidati stafin e pritjes). Në botën tonë të punës në distancë, pyesni asistentët administrativ se si kandidatët i trajtojnë ata përmes emailit. Mënyra se si njerëzit i trajtojnë të tjerët pasqyron karakterin e tyre të vërtetë.

Për të inkurajuar një kulturë të integritetit, unë i pranoj gabimet dhe i inkurajoj të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Për të shqyrtuar këtë, kërkoni nga punëtorët e mundshëm të shpjegojnë një incident që ka ndodhur në jetën e tyre që nuk ka shkuar siç pritej dhe si e kanë zgjidhur atë. Si reagojnë ata zakonisht tregon nëse ata janë të aftë të marrin përgjegjësi kur gjërat shkojnë keq. / www.forbes.com

**PARTIN PRUTHI**

UDHËHEQËS LIGJOR, ZYRA QENDRORE,
TEB BANK SH. A.

Evucioni i parasë – nga perspektiva e shtetit

Sot, vështirë se mund të gjeni një person që nuk ka dëgjuar për kriptovalutat. Këto krijime të reja interesante kanë shkaktuar mjaft bujë në të gjitha aspektet e jetës sonë, veçanërisht për ne që punojmë në sektorin financiar. Cilido qoftë qëndrimi i njerëzve lidhur me pranimin e tyre, kriptovalutat kanë arritur një gjë që nuk ishte bërë për dekada, në mos shekuj: i kanë shtyrë njerëzit të diskutojnë konceptin e vlerës dhe mënyrën se si ne i ruajmë dhe transferojmë ato sot në botën tonë kryesisht dixhitale. Rastisi që disa prej këtyre njerëzve punonin në institucionet financiare që administrojnë politikat monetare (p.sh., Bankat Qendrore) dhe ata u frymëzuan nga kriptovalutat për të eksploruar nëse mund të përmirësohet

roli dhe kontributi i tyre. Së këndejmi, lindi koncepti i valutave dixhitale të emetuara nga Bankat Qendrore.

Dikur, paraja përfaqësohej më së shumti në një formë fizike, qoftë si metale me vlerë, monedha ose kartëmonedha të shtypura në mënyrë të posaçme, por me rritjen e kompjuterizimit, ato filluan të transformohen dhe të bëhen dixhitale. Sot, shumica e parave janë dixhitale. Shumica e njerëzve nuk i mbajnë të gjitha paratë që i kanë në një formë fizike; ata përdorin bankat për të ruajtur paratë e tyre në mënyrë të sigurt. Rrjedhimisht, bankat nuk i ruajnë fizikisht të gjitha paratë që i kanë në zotërim në një kasafortë. Ato mbajnë libra të sofistikuar të kompjuterizuar që evidentojnë se kush u detyrohet atyre

para dhe kujt i detyrohen ata para. Kjo do të thotë që paratë tona dixhitale bazohen në marrëveshje ligjore ndërmjet individëve dhe institucioneve financiare për ruajtjen, transferimin dhe këmbimin e tyre.

Nga ana tjetër, Valutat Dixhitale të Bankave Qendrore (shkurt CBDC, nga gjuha angleze Central Bank Digital Currencies) kanë për qëllim të dalin mbi ato marrëveshje dhe të ofrojnë një platformë të menaxhuar në mënyrë qendrore, ku njerëzit mund të ruajnë dhe të transferojnë para. Ndryshe nga kriptovalutat si Bitcoin ose Ethereum, CBDC-të nuk është e thënë medoemos të bazohen në blockchain ose të decentralizohen. Në një vend ku përdoren CBDC, njerëzit që kanë qasje në to do





të ishin në të njëjtën platformë sikur të gjithë të kishin llogari në të njëjtën bankë. Do të ekzistonte një libër i llogarive i menaxhuar nga qendra, dhe ruajtja dhe transferimi i vlerës do të menaxhohej nga një autoritet qendror.

Arsyet pse ky koncept është duke u eksploruar nga Bankat Qendrore është sepse ai ofron shumë përfitime. Dobia kryesore është efikasiteti: nuk do të kishte nevojë për rrjete bankare dhe të pagesave, skema pagese me kartë, shlyerje fondesh ose ndonjë komplikim tjetër me të cilin jemi mësuar. Pagesat do të transferoheshin menjëherë, sepse ato do të ishin në të njëjtën platformë dhe nuk do të kishte nevojë për një ndërmjetës. Kostot do të ishin më të ulëta, pasi kjo do të ishte një platformë e menaxhuar nga një bankë qendrore. Një tjetër përfitim do të ishte parandalimi i aktiviteteve të paligjshme, të tilla si krimi ose evazioni fiskal. Me një CBDC, paratë mund të gjurmohen se ku

shkojnë dhe kush i ka ato; dhe nëse do të ndodhte ndonjë krim, libri kryesor i llogarive do të mund të ndryshohej në mënyrë që t'i kthehet pronarit të ligjshëm menjëherë. Kjo do t'i bënte ndryshimet e politikës monetare më

të drejtpërdrejta dhe më efektive. CBDC-të gjithashtu kanë disavantazhe. Kryesorja është privatësia. Zbatimi i një CBDC do të nënkuptonte në fakt që një subjekt shtetëror do të dinte se sa para kanë të gjithë përdoruesit dhe ku i transferojnë ato. Shumica e qytetarëve nuk do të donin që një punonjës i bankës qendrore të ketë mundësinë të dijë se ku i blejnë ata ushqimet e tyre, kur dalin për pije, ose cili është ushqimi i tyre i preferuar.

Ndërsa këtu në Kosovë CBDC-të janë një ide kryesisht e pakapshme, Bankat Qendrore të botës janë marrë me eksplorimin dhe implementimin e CBDC-ve tash e ca vjet. BQE ka publikuar një raport dhe vazhdon ta diskutojë atë. Ndërsa Kina, si ekonomia e parë e madhe, tashmë ka vënë në funksion një CBDC. Forma e re e parasë padyshim që po vjen, mirëpo sa jemi të hapur për ta adaptuar atë, ose cili do të jetë roli i bankave, varet nga vetë ne.



Valutat Dixhitale të Bankave Qendrore (shkurt CBDC, nga gjuha angleze Central Bank Digital Currencies) kanë për qëllim të dalin mbi ato marrëveshje dhe të ofrojnë një platformë të menaxhuar në mënyrë qendrore, ku njerëzit mund të ruajnë dhe të transferojnë para.

**MUSA BAJRAKTARI**

Zyrtar i Lartë për Pajtueshmëri,
NLB Banka Sh. A. Prishtinë

**VISAR MALOKU**

Udhëheqës i Njësisë për Pajtueshmëri dhe
Integritet, NLB Banka Sh. A. Prishtinë

Menaxhimi i zhvillimeve të valutave dixhitale nga perspektiva e GRC-së

Korniza e qeverisjes, riskut dhe pajtueshmërisë (shkurt GRC, nga gjuha angleze Governance, Risk, and Compliance) është mbase ‘sistemi’ ose ‘mekanizmi më jetik’¹ që mund të kenë institucionet bankare dhe institucionet e tjera financiare dhe jo-financiare. Për ta thjeshtësuar, GRC është instrumenti me të cilin institucionet angazhohen dhe drejtohen me përpikmëri nga dita në ditë. Në mënyrë të ngjashme, ngjarjet rreth zhvillimit të valutave dixhitale² në vitet e fundit kanë treguar një ndikim të madh në ekosistemin e pagesave dhe infrastrukturën e bankave, Fintech-ëve dhe bizneseve, duke përdorur të dhënat e pagesave për të mirën e konsumatorëve. Evolucioni i valutave dixhitale gjithashtu ka një ndikim në riskun rregullator, posaçërisht në fushat e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe pajtueshmërisë, kështu që nuk mund të shpërfilllet. Në këtë drejtim, risiku i pajtueshmërisë bart një tipar të rëndësishëm në kornizën e përgjithshme të riskut në sektorin bankar dhe shërbimet tjera financiare. As nuk është e mjaftueshme dhe as nuk është e kufizuar në thjeshtë të qenët në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret. Risku i pajtueshmërisë tregon më shumë sesa kjo; ai përfshin parimet gjithëpërfshirëse fiduciare, standardet e kujdesshme etike, dokumentet e klientëve, politikat dhe procedurat e brendshme, dhe detyrimet e tjera kontraktuese.³

Për këtë qëllim, është e rëndësishme të kuptohet raporti i GRC-së, dhe, pse është kaq kritik për suksesin. Në këtë drejtim, një pikënisje është të kuptuarit e larmisë së aktiviteteve që i nënshtrohen rregulloreve. GRC përfshin një ombrellë e cila mbulon qasjen e kombinuar institucionale ndaj tre disiplinave të veçanta të qeverisjes, riskut dhe pajtueshmërisë. Në aspektet praktike, këta tre komponentë përbëjnë një qasje të integruar dhe më holistike në menaxhimin e çështjeve të pajtueshmërisë, llojeve të riskut rregullator, gjë që, nga ana tjetër u mundëson vendimmarrësve të marrin vendime të informuara.⁴ Menaxhimi i zhvillimeve të valutave dixhitale nuk është një përjashtim dhe do të duhej të shihet brenda kornizës së GRC. Në fakt, është një nevojë, për të harmonizuar vazhdimisht zhvillimet e valutave dixhitale me standardet dhe pritjet e pajtueshmërisë rregullatore. Parë nga perspektiva lokale, ne kemi një rregullore që mbulon deri diku kornizën GRC, megjithatë, autorët mendojnë që ekziston nevoja dhe hapësira për rritjen e pajtueshmërisë rregullatore për harmonizimin e mëtejshëm të praktikave të zhvillimit të valutave dixhitale me standardet më të mira.

Çështjet e menaxhimit të zhvillimeve të valutave nuk mund të shihen të izoluar, por të jenë gjithëpërfshirëse

¹ Ideja rrjedh nga materialet studimore të Diplomës Ndërkombëtare në Qeverisje, Risk dhe Pajtueshmëri të ofruara nga International Compliance Association, London, UK.

² Raphael Auer and Rainer Böhme (June 2021), ‘BIS Working Papers No 948 Central bank digital currency: the quest for minimally invasive technology, e lexuar për herë të fundit më 11 qershor 2021, në Central bank digital currency: the quest for minimally invasive technology (bis.org).

³ Ideja rrjedh nga materialet studimore të Certifikatës Globale të Pajtueshmërisë Financiare të mundësuar nga Chartered Institute for Securities & Investments, London, UK.

⁴ Secure Digital Solutions (April 2014), ‘Governance, Risk and Compliance (GRC) White Paper, e lexuar për herë të fundit më 11 qershor 2021, në Governance-Risk-Compliance.pdf (trustsds.com)



dhe çdo aktivitet duhet të mishërohet në qeverisjen e korporative, menaxhimin e riskut dhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet, rregulloret dhe standardet që zbatohen për industrinë bankare dhe shërbimet tjera financiare dhe jo-financiare. Nga njëra anë, do të mund të argumentohet se nuk është e mjaftueshme të përdoren përfitimet e Fintech në lidhje me zhvillimet e valutave dixhitale. Nga ana tjetër, çështjet e menaxhimit të kornizës GRC nuk mund të përparojnë vetëm me aktivitetet e ndjekjes së objektivave që lidhen me valutat dixhitale. Për të qenë të suksesshëm, ne duhet të kemi parasysh kufijtë dhe kufizimet rregullatore, por edhe riskun dhe përfitimet. Për të funksionuar në mënyrë efektive, të gjitha aspektet duhet të harmonizohen dhe të funksionojnë përmes kapaciteteve plotësisht të integruara për GRC. Nga aspektet praktike, një zbatim gjithëpërfshirës i kornizës GRC nënkupton një sistem të burimeve njerëzore, proceseve dhe avancimeve teknologjike⁵ që do t'i mundësonin një organizate, ndër të tjera, të arrijë objektivat që lidhen me valutat dixhitale. Me fjalë tjera, zhvillimet e valutave dixhitale do të duhej të shihen dhe menaxhohen brenda perspektivës së GRC.

Përfitimet e menaxhimit të valutave dixhitale nga perspektiva e kornizës GRC, janë më shumë sesa pajtueshmëria rregullatore dhe rreziku i shmangies së sanksioneve. Korniza GRC paraqet mjetet të cilat duhet të shihen si të integruara në mënyrë gjithëpërfshirëse (dhe jo duke e shqyrtuar se-

cilën në mënyrë të izoluar), në mënyrë që institucionet të funksionojnë në mënyrë të rregullt. Ajo i ofron bordit dhe nivelit të lartë drejtues një qeverisje korporative cilësore për të menaxhuar biznesin. Me fjalë të tjera, korniza GRC rregullon funksionet dhe aktivitetet duke luajtur një rol jetik brenda sistemit kompleks të kompanisë. Përtej kësaj, disa argumentojnë⁶ se GRC është një vlerë e shtuar në masën që na ndihmon të kuptojmë më mirë çështjet e 'jetës reale' që shpesh kufizojnë ose parandalojnë institucionet financiare dhe jo-financiare për të arritur një vlerë maksimale. Në këtë kuptim, korniza GRC mundëson që të gjitha proceset e një kompanie të funksionojnë së bashku në mënyrë efektive, siguron qëndrueshmëri maksimale, pajtueshmëri afatgjatë dhe performancë të përgjegjshme⁷. "Pajtueshmëria nga të gjithë, për të mirën e të gjithëve" është një mesazh që arrihet në mënyrën më të përshtatshme përmes kornizës GRC. Duke e pasur këtë parasysh, funksionimi i sistemeve dhe kontrolleve GRC është thelbësor për zhvillimet efektive të valutave dixhitale duke respektuar standardet dhe pritshmëritë e pajtueshmërisë rregullatore.

Si përmbledhje, kompanitë do të duhej të zbatojnë kornizën GRC në një mënyrë që synon të avancojë dhe të promovojë aktivitetet afariste, të mbrojë interesin e klientëve dhe të ndihmojë ruajtjen e integritetit të tregut.

5 OECG, "Governance, Risk, and Compliance (GRC)": <https://www.org/about/what-is-grc/>

6 OECG, "GRC Capability Model (Red Book) Full Version": <https://go.oecg.org/grc-capability-model-red-book>

7 Ideja rrjedh nga materialet studimore të Diplomës Ndërkombëtare në Qeverisje, Risk dhe Pajtueshmëri të ofruara nga International Compliance Association, London, UK.




ENEIDA THOMAJ
Drejtoresh Menaxhuese,
Paylink Sh. A

Përdorimi i kartave të pagesave në kohën e financave dixhitale

Pandemia që na ka shoqëruar që nga fillim viti 2020, e pritet të vijojë deri më 2022 me synimin e vaksinimit të popullsisë mbarë botërore, mbështeti një aspekt mjaft pozitiv në zhvillimin e pagesave. Kalimi në “erën dixhitale” tashmë është bërë domosdoshmëri për institucionet e pagesave që janë në garë për dhënien e risive dhe “ruajtjen” e klientëve besnikë. Për këtë një sërë skemash besnikërie po ngrihen, sidomos për instrumentet që “vuajtën” nga pandemia (kartat e kreditit) për t’u përdorur edhe për blerje të mallrave bazë jetike e për tu përdorur për blerje me këste në këto segmente etj. Sipas një vërtetimi të kryer nga Capgemini në Nëntor 2020 impakti i pandemisë bëri që nga 24% e klientëve që përdorin e-commerce për të kryer transaksione për më shumë se 51% të shpenzimeve mujore të tyre, kjo vlerë arriti në 47%. Ndërkohë klientët që përdornin e-commerce për më pak se 50% të shpenzimeve mujore të tyre, u impaktuan nga 76% në 53% duke pasur një zhvendosje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme të përdoruesve të e-commerce. I njëjti raport nga Capgemini thekson, se zakone të reja në pagesa vihen re tek konsumatorët, ku rreth 41% e përdoruesve të parasë fizike përdorën karta pagese pa kontakt; 35%

e klientëve që zotëronin një kartë pagese e regjistruan atë në një wallet dixhital; si dhe 27% e konsumatorëve eksperimentuan me pagesat me QR code (ku 2 nga 5 konsumatorë janë mbi 40 vjeç, duke treguar në këtë mënyrë përshtatjen edhe të moshave më të mëdha përballë inovacioneve dixhitale).



Të njëjtat trende dixhitale janë vërejtur edhe në personalizimin e kartave të pagesave përgjatë ciklit të pandemisë.

Zgjerimi i përdorimit të instrumenteve të pagesave në kanalet dixhitale, ka rritur edhe ekspozimin përballë skemave të mashtrimit. Trend që u vu re gjatë pandemisë, ishte përdorimi i kartave të Debitit për blerje online (me një rritje prej 8% në vitin 2020 krahasuar me 2019 sipas Pymnts.com). Sipas të njëjtit studim, rreth 26% e klientëve që përdorin DC për blerje online, pohojnë se lehtësia në përdorimin e DC online tejkalon rrezikun e ekspozimit karshi mashtrimeve e se do të vijojnë në përdorimin e tyre. Megjithatë edhe pse klientët marrin përsipër rreziqet nga mashtrimi, duket se edhe vet institucionet financiare po punojnë për të ndihmuar klientët e tyre në kalimin sa më “të qetë” në funksionet dixhitale që ofrojnë. Kështu, një studim nga Pymnts mbi veprimet e ndërmarra nga bankat përgjatë 2021, pohon se më shumë se gjysma e konsumatorëve kanë

SIGURONI AUTOMJETIN ME KASKO!



ILLYRIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Çdo herë pranë 

www.illyriainsurance.com

 +383 38 750 850

 080075000

SIGURONI SHËNDETIN E FAMILJES!



ILLYRIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Çdo herë pranë 

www.illyriainsurance.com

 +383 38 750 850

 080075000

vështirësi në gjetjen e informacionit në website të institucioneve financiare, e për këtë rreth 49% e të anketuarve pohuan se po përdorin më shumë shërbimet “chat online” të ofruara nga institucionet; rreth 42% e tyre përdorin aplikacionet mobile si mjetin kryesor në edukimin financiar; prej këtyre të fundit rreth 72% janë të prirur të përdorin shërbimet e institucioneve që ofrojnë më shumë informacion në përdorimin e shërbimeve inovatore. Ky trend pavarësisht se u iniciua si pasojë e pandemisë, pritet të ketë qëndrueshmëri edhe pas pandemisë. MC parashikon se rreth 20-30% i kalimit të transaksioneve në e-commerce do të jenë të përhershme për shkak të pandemisë.

Të njëjtat trende dixhitale janë vërejtur edhe në personalizimin e kartave të pagesave përgjatë ciklit të pandemisë.

Lëshuesit e kartave të pagesave tashmë po fokusohen në implementimin e teknologjisë biometrike (shembull autentifikimi i përdoruesit të kartës së pagesës nëpërmjet gjurmës së gishtit, apo rishtazi edhe nëpërmjet zërit të përdoruesit duke dhënë mundësi pagese për personat me aftësi të kufizuara si dhe duke ofruar siguri më të lartë në kuadër të shenjave biometrike unike për individët dhe mjaft të vështira për t'u hacker-uar), apo personalizimi i kartave metalike për të bërë kategorizimin e klientëve dhe benefiteve që përfitohen në kuadër të këtyre instrumenteve të pagesës. Si konkluzion, kohët po ndryshojnë me hapa të shpejtë, e institucionet e pagesave duhet të jenë të vëmendshëm jo vetëm në teknologjinë që implementojnë, por edhe në parashikimin e pritshmërive të klientëve me synimin e qartë të ruajtjes së klientëve besnikë.

RAPORTI NGA CAPGEMINI THEKSON, SE ZAKONE TË REJA NË PAGESA VIHEN RE TEK KONSUMATORËT



41%

E PËRDORUESVE TË PARASË FIZIKE PËRDORËN KARTA PAGESE PA KONTAKT




35%

E KLIENTËVE QË ZOTËRONIN NJË KARTË PAGESE E REGJISTRUAN ATË NË NJË WALLET DIXHITAL



27%

E KONSUMATORËVE EKSPERIMENTUAN ME PAGESAT ME QR CODE

**MENTOR HAJDARAJ**Partner,
RPHS Law**FISNIK SALIHU**Partner Menaxhues,
RPHS Law

Dixhitalizimi i shërbimeve financiare – Vështrim mbi kornizën ligjore dhe rregullative

SHOQËRIA E AVOKATËVE RPHS LAW



Ofrimi i shërbimeve financiare përmes platformave dixhitale është pjesë e pandashme e aktiviteteve të përditshme të institucioneve financiare në Kosovë. Institucionet financiare, dhe në veçanti bankat në Kosovë, kanë qenë mjaft aktive, duke bërë progres të rëndësishëm në zbatimin e teknologji-

ve të avancuara, në hap me zhvillimet e fundit në këtë fushë. Korniza ligjore ka një rol kyç në nxitjen dhe ndërtimin e bazave të bankut dixhital. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë edhe Banka Qendrore e Kosovës, përmes aprovimit të rregullativës ligjore, për të përkrahur dhe mundës-

uar ofrimin e shërbimeve financiare përmes teknologjisë mobile.

Aktualisht, Kosova ka një kornizë ligjore bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse për shërbimet financiare, duke zbatuar praktikat ndërkombëtare, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian.

Legjislacioni i zbatueshëm për e-dokumentet, privatësinë e të dhënave dhe sigurinë kibernetike, janë në përputhje me praktikat më të mira, duke ofruar një kornizë ligjore, që në mënyrë solide mbron klientët.

Pavarësisht avancimit të kornizës ligjore dhe rregullative, praktika e krijimit të raportit kontraktual për të shfrytëzuar shërbimet financiare nuk është përcjellur me qasje të njëjtë. Si rezultat i kësaj, për t'u mundësuar shfrytëzimi i këtyre kanaleve dixhitale për shërbimet financiare, klientët ende janë të detyruar të paraqiten fizikisht në institucionet financiare, për të nënshkruar kontratat dhe dokumentet tjera. Kjo situatë është krijuar për faktin se deri më tani, në përgjithësi ka mbi-zotëruar një qasje konzervative lidhur me atë nëse korniza ligjore e tanishme, lejon shprehjen e vullnetit të palëve për lidhjen e një kontrate përmes mjeteve elektronike dhe pa prezencë fizike.

Ky qëndrim ka ndryshuar dukshëm gjatë pandemisë COVID – 19, për faktin se institucionet financiare janë detyruar të përdorin mjetet elektronike të komunikimit në ofrimin e shërb-

imeve të tyre. Kjo situatë, përveç se ka ndikuar në sjelljen e klientëve, ka ndikuar edhe në një qasje më proaktive dhe të hapur nga institucionet financiare duke mundësuar nënshkrimin e një pjese të dokumentacionit dhe kontratave në distancë.

Nënshkrimi elektronik dhe transaksionet elektronike njihen, dhe pranohen si prova nga gjykatat në Kosovë. Përkundër faktit se ende nuk janë rregulluar në tërësi dy format tjera të nënshkrimit elektronik (nënshkrimi dixhital dhe nënshkrimi elektronik i avancuar), korniza ekzistuese ligjore ofron siguri të mjaftueshme për lidhjen e kontratës në distancë, për shumicën e shërbimeve financiare. Këtu bëjnë përjashtim kontratat të cilat me ligj duhet t'i nënshtrohen procedurave të veçanta (p.sh. kontrata mbi hipotekën). Nga aspekti operacional, mjafton që të ketë një procedurë të brendshme përmes së cilës mund të konkludohet dhe të dëshmohet në mënyrë të qartë se klienti e ka dhënë pëlqimin e tij/saj për përmbajtjen dhe lidhjen e kontratës.

Zhvillimi i vazhdueshëm i parasë elektronike dhe përmirësimi i kornizës

ligjore kanë kontribuar në përmirësimin e efikasitetit të sistemit të pagesave. Regjistrimi i institucioneve financiare jo bankare për emetimin e parasë elektronike dhe shërbimit të pagesave po mundëson krijimin e raporteve kontraktuale në distancë. Si rezultat i kësaj, tërë procedura e lëshimit, mbajtjes dhe përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike nga këto institucione, realizohet në distancë, dhe pa prezencë fizike të klientëve.

Përfundimisht, Kosova ka bërë progres të dukshëm në sigurimin e një kornize ligjore të përshtatshme dhe efektive për transformimin dixhital si dhe gjithëpërfshirjen në sektorin financiar, duke hapur mundësi të shumta të zbatimit të inovacionit dixhital financiar. Duke qenë se transformimi dixhital është bërë i pashmangshëm, mbetet në diskrecion të institucioneve financiare përshtatja dhe zbatimi i kornizës ekzistuese ligjore, duke marrë parasysh edhe ndryshimin pozitiv të praktikës së gjykatave dhe institucioneve tjera relevante lidhur me njohjen dhe pranimin e e-nënshkrimit si dhe transaksioneve elektronike në përgjithësi.





RAMAJ, PALUSHI,
HAJDARAJ, SALIHU
ATTORNEYS AT LAW

A full business law firm providing
unparalleled and tailor-made legal
services in Kosovo.

www.rphs.law / info@rphs.law

SEKTORI BANKAR NË SHIFRA

2021 TM1



210

NUMRI I NJËSIVE BANKARE



513

NUMRI I ATM-VE



13,401

NUMRI I POS-AVE



434,658

NUMRI I LLOGARIVE E-BANKING



1,370,809

NUMRI I KARTELAVE BANKARE



3,353

NUMRI I TË PUNËSUARVE

SHBK me iniciativë të re për instrumentet derivative në tregjet financiare ndërkombëtare – ISDA



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

*Instrumentet derivative në tregjet financiare ndërkombëtare /
Derivative instruments in the international financial markets*

ISDA®

Safe,
Efficient
Markets

26.02.2021, **Prishtinë** Shoqata e Bankave të Kosovës mbajti sot online uebinarin për instrumentet derivative në tregjet financiare ndërkombëtare - ISDA, “Rëndësia e nënshkrimit të marrëveshjeve ISDA CSA me palët ndërkombëtare”.

Diskutimi u drejtua nga Z. Muharrem Inan i cili është Kryetar i Komitetit të Thesarit të SHBK-së dhe Kryetari i Thesarit të Grupit për Institucionet Financiare dhe Banking Privat në BKT.

Gjatë këtij uebinari, folësi kryesor ishte Z. Peter M. Werner, Këshilltar i Lartë në Shoqatën Ndërkombëtare të Shkëmbimeve dhe Derivateve (ISDA), i cili shpjegoi rolin e ISDA dhe bashkëpunimin për çdo përpjekje të ardhshme legislative në Kosovë për një korizë më të mirë ligjore dhe rregullatore.

Gjithashtu prezent ishte edhe Banka Qendrore e Kosovës me një përfaqësues

nga Departamenti i Thesarit duke treguar interes për këtë temë dhe bashkëpunim të mëtejshëm.

Institucionet financiare, kompanitë, madje edhe individët janë subjekt i rrezikut të tregut për shkak të paqëndrueshmërisë në kurset e këmbimit valutor, normat e interesit dhe çmimet e aktiveve financiare. Në këtë drejtim, instrumentet e derivateve janë zhvilluar në tregjet financiare për t’u mbrojtur nga këto rreziqe. Me zhvillimin e tregjeve financiare, derivatet përdoren edhe për qëllime investimi. Instrumentet e derivateve janë kryesisht “Forward, Futures, Swap dhe Options” të cilat kanë një maturim më të gjatë se “spot” (kontratë e blerjes ose shitjes së një malli). Prandaj, këto instrumente u mundësojnë investitorëve të blejnë ose shesin një aktiv në një datë të ardhshme. Në këtë mënyrë, kërkohet të nënshkruhet

ISDA [1] CSA [2] MA [3] me institucionet ndërkombëtare për të qenë në gjendje të hyjnë në transaksione derivatesh. Sidoqoftë, mendimi i ISDA për vendin është një parakusht për nënshkrimin e ISDA, CSA, MA.

Veçanërisht me shfaqjen e pandemisë, Menaxhimi i Riskut u bë më i rëndësishëm për sektorin bankar. Me legjislacionin ekzistues, bankat e Kosovës mund të kryejnë vetëm transaksione spot me institucione ndërkombëtare për shkak të mosekzistimit të opinionit neto për vendin. Prandaj, ai kufizon aftësinë e sektorit në drejtim të praktikave të menaxhimit të riskut. Për më tepër, ai do të përshpejtojë procesin drejt zhvillimit të tregjeve financiare dhe të kapitalit së bashku duke u mundësuar bankave lokale të bashkëpunojnë me institucionet ndërkombëtare.

Sektori bankar mban takim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Fondin për Garanci Kreditore



04.03.2021, **Prishtinë** - Bordi i drejtorëve të SHBK-së, respektivisht përfaqësuesit e bankave komerciale, ishin pjesë e takimeve të organizuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me Fondin për Garanci Kreditore. Në këtë takim u diskutua lidhur me zhvillimet e Fondit, masat e ndërmarra lidhur me implementimin e Dritareve në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes, si dhe planet për zhvillimet e ardhshme lidhur me lehtësim-

in e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, rritjen e punësimit dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Në këtë takim u theksua rëndësia e implementimit të pakos së rimëkëmbjes në atë mënyrë që do të mundësonte financimin e bizneseve me kushte sa më të përshtatshme në mënyrë që të rritet kreditimi dhe të ndikohet në rimëkëmbjen e ekonomisë në Kosovë.

Përfaqësuesit e SHBK-së falënderuan BQK-në dhe FKGK-në për bashkëpunim e tyre ndërinstytucional duke bashkërenditur veprimet për të rritur qasjen në financa.

Sektori bankar ka aprovuar mbi 1.2 miliard euro kredi të reja gjatë vitit 2020 dhe ka dhënë një kontribut të veçantë për tejkalimin e vështirësive financiare të klientëve bankar të shkaktuara si rezultat i pandemisë.



Shoqata e Bankave të Kosovës pjesë e grupit punues për hartimin e Ligjit për Regjistrin e Pronarëve Përfitues

20.04.2021, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës bëhet pjesë e grupit punues për hartimin e Ligjit për Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Gjatë takimit të mbajtur me akterë të ndryshëm ekonomik do të zhvillohet dhe funksionalizohet ky grup punues në vijim.

Shoqata e Bankave të Kosovës përmbyll Javën Ndërkombëtare të Parasë 2021



02.04.2021, Prishtinë - Shoqata e Bankave të Kosovës përmbylli Javën Ndërkombëtare të Parasë 2021. Me këtë rast SHBK bëri edhe ndarjen e çmimeve të garës me ese të cilën e organizoi në kuadër të kësaj Jave. Java e Parasë është pjesë e një fushate globale të ndërgjegjësimit rreth çështjeve të parave.

Tema e Javës së Parasë 2021 dhe gjithashtu tema e garës me ese ishte: “Kujdesu për veten, kujdesu për financat tua” e cila gjithashtu thekson rëndësinë e shprehive

të kursimit si dhe për të arritur mirëqenien financiare dhe qëndrueshmërinë financiare. Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, përgëzoi nxënësit për suksesin e treguar dhe tha: “Është kënaqësi e veçantë për mua që në emër të Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe sektorit bankar të Kosovës të ndajmë këto mirënjohje dhe shpërblime për angazhimin tuaj në mënyrë që të ju mbështesim sa më shumë në zhvillimin tuaj edukativ dhe arsimor, kështu duke kontribuar për një të ardhme më të mirë për të rinjtë e Kosovës”. Balija i uroi suksese të mëtutjeshme fituesve duke vlerësuar se edukimi financiar për të rinjtë në Kosovë është një parakusht për një mirëqenie më të madhe. Ai inkurajoi të rinjtë që të jenë të zellshëm në shkollë për të siguruar kushte më të mira për

veten e tyre por mbi të gjitha edhe për të ndihmuar të tjerët.

Në këtë garë janë përzgjedhur dhjetë esetë më të mira të shkruara nga nxënësit e shkollave publike dhe private të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht janë ndarë edhe çmimet për vendin e 1-rë, 2-të dhe të 3-të. Fituesit e tre vendeve të para janë: Vendi i 1-rë - Nxënësi Erin Laçi nga shkolla “Hasan Prishtina” - Prishtinë, Vendi i 2-të: Nxënësjja Liza Zahiti nga shkolla “European School of Kosova” - Prishtinë, Vendi i 3-të: Nxënësi Gerti Dreni nga shkolla “Fehmi Agani” - Gjakovë. Në ngjarjen e ndarjes së çmimeve nxënësit mësuan më shumë rreth Javës së Parasë dhe rolit dhe misionit të Shoqatës së Bankave të Kosovës si zëri i industrisë bankare në Kosovë.



FORUMI I HAPJES SË JAVËS SË PARASË 2021



Anesa Besimi
Shoqata e Bankave të Kosovës (Moderatore)



Petrit Balija
Shoqata e Bankave të Kosovës



Ajshe Ramosaj Ahmetaj
Banka Dendrore e Kosovës



Antigona Bejtullahu
Raiffeisen Bank



Syzana Dautaj
IFC



Arta Shehu
J-coders



Iliriana Nreca
NLB Bank

“RËNDËSIA E EDUKIMIT FINANCIAR PËR TË RINJTË NË KOSOVË – JAVA E PARASË 2021”

E HËNË, 22 MARS 2021,
10:00 FACEBOOK LIVESTREAMING



Gjatë kësaj Jave SHBK organizoi aktivitete të ndryshme, shumicën nga të cilat i zhvilloi në mënyrë virtuale. Disa nga aktivitetet e mbajtura ishin : Forumi i hapjes së Javës së Parasë me temën “Rëndësia e edukimit financiar për të rinjtë në Kosovë – Java e Parasë 2021, Publikimi i materialeve edukative rreth financave; Ligjëratat online me nxënësit e shkollave fillore, Artikuj të ndryshëm

rreth edukimit financiar, Gara me Ese me temën “Kujdesu për veten, kujdesu për financat tua”.

Shoqata e Bankave të Kosovës është pjesë e këtij organizimi që nga viti 2013, i cili organizohet nga Rrjeti Ndërkombëtar i OECD për Edukimin Financiar (OECD / INFE) dhe mbështetet nga bankat komerciale të Kosovës.

Adresohet çështja e përdorimit të adresave zyrtare për verifikim të klientëve bankar



12.05.2021, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës mbajti takim virtual me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Qëllimi i këtij takimi ishte mundësia e përditësimit të të dhënave për adresat për klientët bankar, respektivisht që adresa unike për secilin klient të nxirret nga aplikacioni për administrimin e sistemit të adresave.

Shoqata e Bankave të Kosovës takohet me përfaqësues nga Agjencia Franceze për Zhvillim

09.06.2021, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës ka pritur në takim përfaqësuesit nga Agjencia Franceze për Zhvillim. Takimi u realizua në kuadër të misionit të parë të ekipit mbi analizën makro-ekonomike, analizën e riskut të vendit dhe riskut sovran të Kosovës. Misioni ishte i fokusuar në 6 shtylla kryesore : Ambienti socio-politik; Trajektorja e rritjes, Financat publike, Ekuilibrat e jashtëm, Sistemi financiar dhe Ekspozimi ndaj riskut fizik, të shoqëruar me ndryshimet klimatike.



Nënshkrimi elektronik, mundësi për sektorin bankar



20.05.2021, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi forumin virtual “Nënshkrimi elektronik dhe shërbimet bankare” gjatë datës 20 maj 2021.

Nënshkrimi elektronik është një nga hallkat e rëndësishme të dixhitalizimit të shërbimeve bankare. Një nga sfidat dhe vështirësitë në Kosovë që vazhdon të mbetet është mungesa e mekanizmeve zbatues të aplikimit të nënshkrimit elektronik në shërbimet financiare por edhe në përgjithësi në sektorin privat.

Duke pasur parasysh edhe zhvillimet gjatë periudhës pandemike, rritja e shkallës së dixhitalizimit të shërbimeve financiare është bërë edhe më e rëndësishme.

Paneli u moderua nga Z. Kreshnik Kozumi – Zyrtar i lartë për Operacione në Shoqatë të Bankave të Kosovës, ndërsa panelistë të këtij forumi ishin: Z. Partin Pruthi – Udhëheqës i Departamentit Ligjor, TEB, Z. Arbër Rogova – Arkitekt i ndërmarrjes, RBKO, Z. Idajet Berisha –

Këshilltar Ligjor, RBKO, Z. Anton Sokoli – Menaxher i Zhvillimit të Produkteve, TEB, dhe Z. Adonis Bllacaku – Udhëheqës i Departamentit të Shitjes me Pakicë & Marketingut, BpB.

Sektori bankar në Kosovë është rritur me shpejtësi, duke ecur në hap me standardet moderne bankare duke përmirësuar vazhdimisht shërbimet financiare për ekonominë e vendit duke ruajtur stabilitetin financiar.

ASAMBLEJA E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS ZGJODHI KRYESINË



ALBERT LUMEZI



SUAT BAKKAL

02.06.2021, **Prishtinë** Shoqata e Bankave të Kosovës me datë 27.05.2021 mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me ç ‘rast zgjodhi kryesinë e re dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve për mandat dy-vjeçar (2021-2023). Gjatë kësaj mbledhje, me vota unanime për pozitën e Kryetarit të Bordit është rizgjedhur: Z. Albert Lumezi, Kryeshef Ekzekutiv i NLB Banka ndërkaq Nënkyetar i Bordit u zgjodh: Z. Suat Bakkal, Kryeshef Ekzekutiv i Bankës Kombëtare Tregtare.

Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balija uroi rizgjedhjen e kryetarit të Bordit, Z. Albert Lumezi, dhe zgjedhjen e nënkryetarit Z. Suat Bakkal duke potencuar se viti që lam pas shkaktoi sfida dhe vështirësi të mëdha për të gjithë, mirëpo angazhimi dhe koordinimi përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës, së bashku me bankat komerciale në vend, autoritetet shtetërore dhe palët bashkëpunuese ka bërë që kreditimi i ekonomisë dhe shërbimet bankare të vazhdojnë pa ndërprerje dhe njëkohësisht është siguruar stabilitet dhe siguri për sektorin bankar në vend.

Me këtë rast Z. Albert Lumezi tha: “Sektori bankar ka dëshmuar se funksionon në mbështetje të ekonomisë së vendit si në kohë të zhvillimit ekonomik ashtu edhe në situata të vështira siç ishte pandemia. Sektori bankar ka një rëndësi të madhe për ekonominë e vendit, për rritjen e qasjes në financa, rritjen e punësimit dhe funksionimin e hallkave të tjera të ekonomisë. Prandaj besoj fuqimisht se me përpjekjet e përbashkëta dhe vazhdimin e bashkëpunimit shumë të mirë të gjithë anëtarëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës do të tejkalojmë të gjitha sfidat që janë të pranishme në sektorin bankar dhe në mjedisin e jashtëm të të bërit biznes.”


Ndërsa Z. Suat Bakkal falënderoi anëtarët e Asamblesë për mbështetjen e tyre për mandatin e dy viteve të ardhshme. Me këtë rast ai tha: “Industria jonë do të përballlet me konkurrencë të fortë, kërkesa të mëdha rregullative dhe kërkesa me standarde të larta për qeverisje gjatë kësaj periudhe. Prandaj, besoj që me një bashkëpunim shumë të mirë me Kryetarin Z. Lumezi dhe Anëtarët e Bordit do të mbajmë të shëndetshëm

sektorin bankar në mënyrë që të jetë i gatshëm për mbështetjen afatgjate ekonomike të Kosovës”.

Anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës u konfirmuan: Robert Wright – CEO Raiffeisen Bank Kosovë, Eriola Bibolli – CEO Pro-Credit Bank Kosovë, Orçun Ozdemir – CEO TEB, Shpend Luzha – CEO Banka Ekonomike, Arton Celina – CEO Banka për Biznes, Oguzhan Ceylan – Drejtor i Përgjithshëm IS Bank – Dega në Kosovë, Meriton Sunduri – Drejtor i Përgjithshëm Ziraat Bank - Dega në Kosovë, Selman Lamaj – CEO Credins Bank Kosovë dhe Petrit Balija - CEO SHBK.

Ndër temat e diskutuara në këtë takim ishin edhe Ligji për Banka dhe tema tjera me rëndësi për sektorin bankar ndërsa, u vlerësua lartë puna aktuale e Shoqatës së Bankave të Kosovës në përfaqësimin e sektorit bankar dhe menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve kritike gjatë situatës së pandemisë me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të sektorit bankar dhe rritjes së qasjes në financa për qytetarët dhe bizneset e Republikës së Kosovës.

Fondi Monetar Ndërkombëtar mban takimin e radhës konsultues me sektorin bankar në Kosovë



04.06.2021, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës mbajti takimin e radhës me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në këtë takim u diskutuan zhvillimet e fundit ekonomike në vend, masat lehtësuese dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe stabiliteti financiar i tregut në Kosovë.

Anëtarët e Bordit të SHBK-së adresuan një sërë çështjesh të cilat do të ndihmonin në avancimin e sektorit bankar dhe rritjes së qasjes në financa, përfshirë këtu edhe nevojën për të miratuar draft ligjin për Bankat, implementimin e vlerësimit të kredisë së vendit (country rating), etj. Të pranishmit e këtij takimi u dakorduan për të vazhduar konsultimet më të detajuara për çështje tjera specifike në ditët në vijim.

Ministri Murati dhe Shoqata e Bankave të Kosovës diskutuan për emetimin e bonove të diasporës



11.06.2021, **Prishtinë** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati priti sot në takim Shoqatën e Bankave të Kosovës si dhe përfaqësuesit e bankave komerciale në Kosovë, ku u diskutua për iniciativën e re të Qeverisë së Kosovës për emetimin e bonove të diasporës.

Me këtë rast, ministri Murati prezantoi këtë nismë të Qeverisë së Kosovës si njëra ndër pikat kyçe të programit qeverisës, pikë kjo që ka për qëllim kanalizimin e kapitalit të diasporës sonë drejt investimeve strategjike që krijojnë vende pune dhe rezultojnë në rritje të zhvillim ekonomik.

Ministri Murati theksoi se Qeveria e Kosovës është e interesuar që në bashkëpunim me BQK-në dhe bankat komerciale të lansojnë bonot e diasporës si produkt i ri, i cili i dedikohet bashkatdhetarëve tanë.



“BËHU PRAKTIK, PAGUAJ ME KARTË” LANSOHET KAMPANJA NGA SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS NË BASHKËPUNIM ME MASTERCARD



Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Mastercard lansojnë kampanjën informuese për përdorimin e kartave bankare “Bëhu praktik, Paguj me Kartë”.

Tregu i pagesave në Kosovë është duke u zhvilluar tutje dhe shërbimet dhe produktet bankare janë në hap të dixhitalizimit. Edhe bankat komerciale në Kosovë i bashkërenditen standardeve të reja në sofistikimin e produkteve. Këtu mund ti listojmë edhe pagesat që kryhen me kartë bankare, ku, kartat bankare mundësojnë kryerje të shërbimeve / pagesave pa humbur kohë, në mënyra shumë të sigurta dhe pa ndonjë kosto shtesë. Qytetarët dëshirojnë të kenë mënyra të

ndryshme të të paguarit andaj, me anë të kësaj kampanje, qytetarët mund të informohen rreth përfitimeve të shumta që i ofron pagesa me kartë bankare pa kontakt. Disa nga përfitimet e shumta të pagesave pa kontakt janë:

Siguri dhe efikasitet në pagesat tuaja duke mundësuar pagesën edhe për transaksionet për shumta të vogla dhe të përditshme.

Ju kurseni kohë dhe nuk do keni nevojë që çdo herë të bëni tërheqje të parasë KESH në bankomat, të prisni në radhë në sportele të bankave apo të mbani KESH me vete, gjithashtu me kartë bankare mund të bëni blerje dhe pagesa online. Pagesat me kartë bankare mund të bëhen

në të gjitha pajisjet POS të bankave të Kosovës, pa provizion dhe pa dallim në shumën që e paguani, pra provizioni për pagesë me kartë është ZERO.

Pagesat me kartë bankare regjistrohen në raportin tuaj bankar duke mundësuar menaxhimin më të mirë të shpenzimeve dhe financave personale.

Pagesat me kartë bankare ndihmojnë në luftimin e ekonomisë jo-formale dhe parandalimin e shpërndarjes së parasë së falsifikuar.

Kampanja do të zhvillohet gjatë muajve qershor – gusht 2021 dhe pritet të ketë ndikim pozitiv në informimin e qytetarëve dhe shoqërinë kosovare, për avancimin e tregut të pagesave.



Banka Ekonomike sponsor i FC Mabetex Prishtina Futsall

Ka vazhduar mbështetja e Bankës Ekonomike për projektet sportive, së fundi, në kuadër të përgjegjësisë sociale, kemi mbështetur edhe klubin e futsallit, kampionin aktual FC Mabetex Prishtina.

Ky hap, ri konfirmon edhe njëherë se si institucion vendor, jemi të përkushtuar në mbështetjen e aktiviteteve të cilat i

kontribuojnë zhvillimit të rinis dhe rritjes së mirëqenies.

FC Mabetex Prishtina është klub i cili së fundi bëri historinë duke marr pjesë në garat kualifikuese të UEFA Champions League, ku zhvilloj ndeshje edhe kundër kampionit të Spanjës, Barcelona Futsall.

Banka Ekonomike sponsor i Klubit të futbollit SHKËNDIJA

Mbështetja e sportit është një tjetër dimension i veçantë për të cilin Banka Ekonomike është angazhuar në vazhdimësi, veçanërisht projekteve sportive me ndikim të drejtpërdrejt tek te rinjtë.

Futboli si sporti më i popullarizuar, për zhvillim të mëtejshëm, rritje të cilësisë dhe masivizim, pa dyshim se ka nevojë për mbështetje institucionale, e në këtë

drejtim, Banka Ekonomike ka vendosur të e mbështes projektin e Klubit të futbollit Shkëndija.

KF Shkëndija është një klub i ri i sapo formuar i cili garon në ligen e tretë të Kosovës dhe aktualisht është shpallur kampion vjeshtor në këtë grup. Klubi gjithashtu ka një akademi mjaft të organizuar.



Banka Ekonomike mbështet realizimin e Serialit “Kosovarët”

Fusha e kulturës është një tjetër segment të cilit Banka Ekonomike i kushton rëndësi të veçantë. Në këtë drejtim, së fundi kemi mbështetur projektin më të ri i cili është në zhvillim e sipër, serialin “Kosovarët”.

Përmes këtij projekti filmik, i cili do të jetë prodhim vendor, hartuar nga skenaristi dhe regjisori Amerikan

Darren Denison, do të pasqyrohet rrugëtimi i vështirë i popullit shqiptar dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësismit të vendit tonë.

Ky projekt synon të transmetohet në audiencën vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim që të pasqyrohet lufta e drejtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

BKT Kosova në mbështetje të Kooperativës Bujqësore KRUSHA



BKT Kosova ka mbështetur hapjen dhe funksionimin e objektit të ri të Kooperativës Bujqësore KRUSHA, inaugurimi i se cilës u bë më 8 Mars, për faktin se historia e kësaj kooperative është e lidhur ngushtë me fuqinë e grave të Krushës së Madhe.

Heroina jonë Znj. Fahrije Hoti së bashku me gratë e Krushës, kanë hapur dyert e fabrikës së re, duke vazhduar të japin kontributin e pashoq në fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri. Znj. Fahrije Hoti ka falënderuar BKT Kosova për kontributin e dhënë në realizimin e këtij projekti.



“Gjaku yt shpëton jetë”

Prej vitesh BKT Kosova vijoi me misionin e saj humanitar të dhurimit të gjakut në bashkëpunim me Transfuzionin i Gjakut - Kosovë për t’iu ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë.

Edhe kësaj radhe aktiviteti i dhurimit të gjakut i organizuar nga BKT Kosova ishte i suksesshëm. Kjo ishte e dukshme nga entuziazmi i treguar nga punonjësit e Bankës që mbështetën plotësisht aktivitetin. Ky entuziazëm u mirëprit edhe nga Zyrtarët e Qendrës për Transfuzion të Gjakut, të cilët ishin shumë

të kënaqur me interesimin e madh të punonjësve për të dhuruar gjak.

BKT Kosova shpreson që vullnetarizmi i punonjësve të saj të shërbejë si shembull i mirë për rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës për të dhuruar gjak dhe për të shpëtuar jetën atyre që janë në nevojë.


“Gjaku yt shpëton jetë” është pjesë e programit të bankës për përgjegjësi sociale, i bazuar në parimin “Kontribuo për shoqërinë” që mbështet veprimtaritë bamirëse.

BKT Kosova vazhdon të mbështesë fëmijët me autizëm

Për nder të Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, BKT Kosova sërish ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën ‘Autizmi’ me seli në Prishtinë, për vazhdimin e mbështetjes financiare në trajtimin e fëmijëve me autizëm, edhe për 12 muaj të tjerë.

Kjo mbështetje u mirëprit nga Shoqata “Autizmi” - Prishtinë e cila falënderon BKT Kosovën për mbështetjen e vazh-

dueshme, ndërsa shpresojnë që shembullin e tillë ta ndjekin edhe të tjerët. Mbështetësit financiarë konsiderohen si burim i pazëvendësueshëm për arritjen e misionit dhe vizionit të shoqatës, drejt krijimit të një ambienti më të mirë shoqëror në mbështetje të fëmijëve me autizëm. BKT Kosova vazhdon të mbështesë aktivitete që në qendër kanë ndikimin pozitiv në shoqëri.



NLB Banka dhuron pajisje mjekësore dhe medikamente për QKUK



Duke parë kushtet e vështira dhe sfidat me të cilat po përballet Qendra Klinike Universitare e Kosovës, NLB Banka ka dhuruar pajisje mjekësore dhe medikamente në vlerë prej 19,765 €. Pjesa e parë e donacionit është dorëzuar në Dhjetor 2020 ndërsa në Mars janë dorëzuar dy Mikroskop Trinocular në Klinikën e Pediatriisë për repartin e Hematologjisë dhe pajisje mjekësore për Klinikën e Anesteziologjisë ku trajtohen pacientët me gjendjen më të rëndë të shkaktuar nga Covid-19.

Duke nënshkruar Parimet e Kombeve të Bashkuara për Bankë të përgjegjshme, NLB Banka është zotuar në mbështetjen aktive të zhvillimit të qëndrueshëm në shoqëri.

NLB Banka vazhdon mbështetjen për bizneset mikro dhe të vogla përmes projektit #KornizaeMbështetjes

Bizneset vendore individuale, mikro dhe të vogla janë shtyllë e rëndësishme e ekonomisë dhe janë prekur më së shumti nga pandemia COVID-19. Kjo është arsyeja pse NLB Banka ka përgatitur edhe këtë vit projektin #KornizaeMbështetjes për t'i mbështetur në rikthimin pas pandemisë dhe në zhvillimin e biznesit duke ju dhuruar hapësirë reklamuese në kanale televizive, portale informative, billboard dhe citylight në të gjithë Kosovën.

Përmes projektit #KornizaeMbështetjes ne do të ndihmojmë bizneset mikro, bizneset e vogla, që kanë aktivitet: prodhimin e produkteve vendore, tregtinë, shërbimet, agrokulturën si dhe të cilat sjellin projekte inovative për mbrojtje të mjedisit dhe mirëqenies sociale duke ju dhuruar hapësira reklamuese.

Afati për aplikim është mbyllur. Komisioni do të shqyrtoj aplikacionet dhe do të bëjë përzgjedhjen në bazë të kriterëve.

 **NLB #KornizaeMbështetjes**

**Kjo është hapësira
për reklamimin
e biznesit tuaj.**

Aplikoni tani në:
**[nlb-kos.com/
korniza](https://nlb-kos.com/korniza)**

#SëBashkumëtëFortë

“Vepra e saj” është mbështetur nga banka Raiffeisen në Kosovë



“Vepra e saj” nga Alketa Xhafa Mripa, libër i cili shpalos tregimet për gratë pioniere shqiptare nga Kosova u promovua në librarinë Dugagjini në Prishtinë më 12 prill 2021 me një interesim të jashtëzakonshëm për blerjen e kësaj vepre.

“Vepra e saj” përmbledh historitë personale të 100 femrave të cilat me mund dhe vullnet të palëkundur avancuan ëndrrën e tyre: ëndrrën e grave të guximshme që besuan në talentin, pasionin dhe aftësitë e tyre për të lënë gjurmë të thella në të gjitha hallkat e shoqërisë kosovare, që nga artet, arsimi, shëndetësia, ekonomia, shkenca, sporti e deri te forma të llojllojshme të aktivizimit.

“Vepra e saj” është përkrahur nga banka Raiffeisen në Kosovë si pjesë e kontributit për shoqërinë, në këtë rast - fuqizimin e gruas.

Chopin Piano Fest kthehet pas një viti pauzë pas pandemisë



Kultura mbetet një nga fushat kryesore ku Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të angazhohet, prandaj edhe gjatë këtij viti kemi mbështetur një nga ngjarjet kryesore kulturore - Chopin Piano Fest. Festivali i Pianos Chopin ofron koncerte, kurse ma-

ster për studentët dhe një simpozium kushtuar jetës dhe veprës së kompozitorëve ose pianistëve që përkujtohet çdo vit në të gjithë botën. Banka inicoi dhe mbështeti seminare të veçanta dhe kurse master për artistë të rinj gjatë festivalit në mënyrë

që të mundësohet veprimtari edukative kulturore për studentët që vijnë nga universiteti ose shkollat e mesme.

Kështu, këtë vit, Chopin Piano Fest përfshiu edhe javën “EduWeek” me një program të veçantë edukativ.

Banka TEB dhe Komiteti Olimpik i Kosovës arrijnë marrëveshje sponsorizimi

Pas përkrahjes së dëshmuar ndaj disa sporteve të rëndësishme, Banka TEB tani është edhe sponsor i Lëvizjes Olimpikë në Kosovë apo më saktë, Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK).

Marrëveshja e arritur ndërmjet drejtorit menaxhues të TEB Bankës, Orcun Ozdemir dhe presidentit të KOK-ut, Ismet Krasniqi përmban përkrahjen për katër vitet e ardhshme të frymës olimpikë dhe aktiviteteve të tyre të rregullta vjetore.

Banka TEB është sponsor edhe i Federatës së futbollit të Kosovës (FFK) dhe Federatës së basketbollit të Kosovës



(FBK), të gjitha këto marrëveshje në kuadër të strategjisë për të përkrahur federatat kombëtare në paraqitjen sa

më të mirë të tyre në planin ndërkombëtar dhe projektet e ndryshme sportive kombëtare.

ProCredit Bank mbjell 452 drunj në parkun e Kampusit të Universitetit të Prishtinës

ProCredit Bank, si bankë që kontribuon çdo ditë në kujdesin për mjedisin ka mbjellë sot 452 drunj në parkun e Kampusit të Universitetit të Prishtinës.

Më shumë se 113,703 m2 sipërfaqe publike është gjelbëruar dhe do të pajiset me ulëse dhe shporta – duke e shndërruar këtë hapësirë në park të rehatshëm për qëndrim dhe shfrytëzim për qytetarët. Ky investim i Bankës ProCredit është mundësuar në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës.



BPB sponsorizon Federatën e Tenisit të Kosovës

Banka për Biznes (BPB) është bërë sponsor gjeneral i Federatës së Tenisit të Kosovës, me qëllim të avancimit të sportit të tenisit. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga drejtori ekzekutiv i Bankës për Biznes, Arton Celina dhe kryetarit të Federatës së Tenisit të Kosovës, Mejdi Rexhepi.



ÇFARË JANË AKADEMITË E NDËRMARRËSISË?

Shpesh të quajtura si shërbime jo-financiare ose shërbime mbështetëse të biznesit që janë shërbime të zhvillimit të ndërmarrjeve ose shërbime të vlerës së shtuar, Akademitë e Ndërmarrësisë plotësojnë ofertat financiare të një banke.

Tabela më poshtë tregon shembuj të shërbimeve të tilla.



KONSULENCË

Trajnim dhe këshillim nga kompani konsulente të jashtme me aftësi të larta dhe gjithashtu nga ekspertë të bankave në vend.



TRAJNIME

Seminare specifike të punës për aftësitë e planifikimit të biznesit dhe strategjive të zhvillimit dhe menaxhimit financiar.



STATISTIKA DHE MBËSHTETJE INFORMACIONI

Artikuj mbi NMVM, platforma në internet, revista, materiale mediatike.



RRJETËZIM

Ngjarje të punëtorive/takime dhe shkëmbimi i përvojës, shërbimet e biznesit dhe klubet.

PSE BPB?

- Ne jemi liderë të tregut për mikro biznese dhe shumë konkurrues në segmentin agro dhe të NVM
- BPB ka përvojë në programin e përfshirjes financiare
- Ne kemi ofruar jo vetëm qasje në financa por edhe zgjidhje të përshtatura enkas sipas edukimit financiar
- Kemi implementuar disa shërbime dhe produkte të orientuara drejt zgjidhjes specifike të biznesit (Cash Advance/SME CSP), duke krijuar tregje dhe mundësi aty ku ato janë të nevojshme më shumë
- Mbi 11 mijë klientë aktivë të NMVM, dhe mbi 88 milionë € të kredive aktive
- Qasje holistike për klientët e NMVM (qasje e limitit të kredisë)

PROPOZICIONI YNË I VLERËS?

• BPB ka kryer vlerësime dhe hulumtime të tregut me klientë ekzistues dhe potencialë për të vlerësuar nevojat e NMVM-ve. Ne kemi theksuar dhe nxjerrë analiza të hendekut me qëllim për të ndërtuar ekosistemin e ardhshëm të ndërmarrësisë.

Sfidat për të cilat ne ofrojmë zgjidhje:

- planifikimi dhe pozicionimi strategjik
- strategjia e rritjes.

- Ne ofrojmë udhërrëfyesin për në peizazhin e konkurrencës së tregut,
- Strategjia për zhvillimin e BNJ,
- Njohuri financiare, me tregues të performancës për të matur operacionet e biznesit

• Zgjidhje dhe shërbime specifike dhe të përshtatura:

- Artikuj të NVM-ve me interes të informacionit
- Akademitë e ndërmarrësisë, të ofruara nga konsulentët dhe stafi i bankave



BPB së bashku me partnerin e saj strategjik FEEJ po ofrojnë zgjidhje të personalizuar në lidhje me sfidat e NMVM-ve që u përshtratan nevojave të klientëve të biznesit. Përveç kësaj, ne bashkohemi me klientët për sa i përket pozicionimit strategjik duke u rritur së bashku përmes parimit të shkallëzimit.



- Qasje e ndryshme në krijimin e mundësive të biznesit, mundësi të segmenteve të reja
- Kontributi në menaxhimin e marrëdhënieve

AKADEMITË E BIZNESIT

Banka Për Biznes, në bashkëpunim me partnerin e saj strategjik European Fund For Southeast Europe (EFSE), ka filluar me ofrimin e shërbimeve jofinanciare apo shërbimeve mbështetëse për bizneset e vogla në Kosovë.

Këto shërbime jofinanciare, të ashtuquajtura Akademi të Ndërmarrësisë/

Biznesit, ofrojnë trajnime të ndryshme të cilat do të ju japin mundësi bizneseve të zhvillojnë planet e tyre strategjike, planet e marketingut dhe menaxhimin e financa-ve, duke iu lehtësuar menaxhimin, rritjen dhe vazhdueshmërinë e bizneseve të tyre.

Këto akademi do të organizohen në 7 qytetet më të mëdha të Kosovës, ku

pjesëmarrës do të jenë rreth 300 biznese. Trajnimet në këtë akademi do t'i mbaj kompania GURU Academy nga Turqia, kompani kjo me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e konsulencës për biznese.

Pjesëmarrja në këto akademi do të jetë pa pagesë për të gjithë klientët.



BPB

në partneritet me


Entrepreneurship Academy
powered by EFSE

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë publikun lidhur me industrinë bankare në Republikën e Kosovës. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e Shoqatës së Bankave të Kosovës.



PUBLIKIME TË TJERA NGA SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS





QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS

Ofron trajnime për sektorin financiar të Kosovës



INVESTIMI MË I MIRË ËSHTË EDUKIMI



PARTNERËT:

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



HOUSE OF TRAINING



Qendra për trajnime bankare në kuadër të programit të saj të trajnimeve ofron edhe çertifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 #KosovoBankingAssociation

 #KosovoBankingAssociation

Shoqata e Bankave të Kosovës
është anëtare e Rrjetit Evropian
për Trajnime Bankare (EBTN).

<https://www.bankassoc-kos.com/>

